



**HULUMTIM ME TEMËN
“DHUNA NË SHKOLLA”**

GUSHT 2013

Hyrje

Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla është një kusht elementar për maksimalizimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të sistemit të arsimit në Kosovë, në përgjithësi, dhe të atij të detyruar në veçanti. Po ashtu, krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane e miqësore për fëmijë me nxënësin në qendër është *conditio sine qua non* për ndërtimin e një shoqërie demokratike, multikulturale, multietnike me njeriun në qendër(Lexo: nenin 31 të KDF). Vetëm shoqëritë me njeriun në qendër janë shoqëri kohezive dhe të lumtura.

Dhuna në shkolla është një dukuri shoqërore mjaft shqetësuese. Në vitet e fundit, një perceptim i përbashkët është shfaqur ku mendohet se dhuna është bërë më e përhapur nëpër shoqëri, duke e përfshirë edhe sistemin e edukimit. Dhuna në shkolla reflekton çka është duke ndodhur në një shoqëri si tërësi. Ky hulumtim ka për qëllim të identifikojë sfidat e sigurisë të cilat mund të jenë të pranishme nëpër shkolla.Për realizimin e këtij hulumtimi janë përdorur metoda e intervistimit dhe e analizimit të teksteve/raporteve.Janë intervistuar drejtorët e 4 shkollave të mesme të Mitrovicës, si dhe 20 nxënës të po këtyre shkollave. Poashtu,është intervistuar drejtori për arsim i komunës së Mitrovicës, dy oficerë nga Policia e Kosovës, njësitë i policisë në komunitet, sidhe 5 prindër. Të intervistuarit janë pyetur se sa incidente dhe të çfarë lloji kanë qenë ato që kanë ndodhur gjatë vitit 2012-2013 në shkollat e tyre. Ata gjithashtu janë pyetur se me çfarë probleme janë ballafaquar përderisa i kanë adresuar këto incidente.

Ky hulumtim jep një pasqyrë të situatës së tanishme në Mitrovicë dhe nuk ka për qëllim të konkludojë se situata është e njëjtë nëpër shkollat e mesme në komunat tjera, edhe pse gjasat janë të mundshme. Dëshmitë në këtë publikim janë bërë me qëllim që të ngrisin vetëdijen për çështjen e sigurisë në shkolla për ata të cilët nuk janë të njoftuar me temën dhe t'i përkujtojmë ata të cilët janë duke u marrë me problemin sepse ai është ende i pranishëm.

Format e dhunës në shkollë

Ne teoritë mbi dhunën, sot ekzistojnë mbi dhjetëra klasifikime të dhunës.¹ Johan Galtung-u(1930), sociolog norvegjez me dhunë nënkupton:”...ndikimi negativ në nevojat themelore (

¹ Unicef (Priručnik. Stop nasilju redju decom.Projekat ZA SIGURNO I POTENCIALNO OKRUŽENJE U ŠKOLAMA. Prevencija i borba protiv nasila redju djecom (2003- 2005, f.13)

bazike) të njeriut(ose jeta) jeta të cilës mund t'i shmangemi dhe që kufizon mundësinë potenciale për kënaqjen e këtyre nevojave²”. Kërcënim me dhunë është dhunë, indiferenca, moskujdesi, mospërfillja, varfëria janë dhunë sepse pengojnë plotësimin apo kënaqjen e nevojave tona bazike.

Në fakt sot flitet për dy lloje të dhunës kryesore: dhunën strukturore dhe dhunën e drejtpërdrejt. Dhunë strukturore është kur sistemi i arsimit nuk është efikas dhe efektiv dhe si i tillë pengon zhvillimin e individit dhe të shoqërisë që të vetë-realizohet. Mos përgatitja e mësimit dhe mos-zotërimi i kompetencave të duhura për zhvillimin efikas dhe efektiv të mësimit është dhunë strukturore. Megjithëse në këtë hulumtim ne jemi marrë vetëm me dhunën e drejtpërdrejt(dhuna fizike, psikike emocionale, shpirtërore,orale, sociale, eksplicite, implicite etj), patjetër duhet sqaruar se dhuna strukturore e përhapur gjithandej në shoqërinë kosovare bën që mjediset shoqërore dhe shkollore të konsiderohen si të dhunshme. Për fat të keq, sot rrallë kush në Kosovë , merret me këtë lloje dhune, pa evitimin e saj nuk do të mund të evitohen edhe llojet tjera të dhunës së drejtpërdrejtë.

Edhe pse dhuna fizike e mësimit është në rënie, dhuna fizike mbi nxënës është tejet shqetësuese.³

Nga 20 nxënësit e intervistuar, në pyetjen “*a ushtrohet dhunë fizike mbi ju ?*”, 2 prej tyre kanë konfirmuar faktin se përdoret dhunë fizike ndaj tyre.Me qëllim që të konstatohet se a luan rol gjinia në ushtrimin e dhunës, është analizuar hulumtimi i qendrës për Arsim dhe shkencë në bashkëpunim me Unicef-in.⁴Ky raport thekson se ka një tendencë më të madhe të ushtrimit të dhunës ndaj gjinisë mashkullore ku si rrjedhojë gjinia mashkullore janë tri herë më shumë objekt i dhunës sesa gjinia femërore.Poashtu i njejt studim tregon se vajzat në këtë moshë për shkak të edukimit ende patriarkal në familje janë më të tërhequra dhe më të prirura për të respektuar rregullat dhe përgjegjësitë shkollore andaj ndaj tyre merren më pak veprime represive.

Një statistikë interesante është se përderisa dhuna e mësimit ndaj nxënësve është në rënie, ka një rritje të dhunës ndërmjet vetë nxënësve.Megjithatë, pjesëmarrësit në konfliktet që shkaktojnë dhunën janë të kategorive të ndryshme, nxënës, mësimit madje edhe prindër.

Por brenga më e madhe është implikim i huliganëve të cilët nuk janë pjesë e shkollave fare.

² Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shoqëri dhe shkolla, Prishtinë, shkurt 2009

³ Hyseni, (H 2004): Të drejtat e fëmijës në shtëpi e nxënësve kosovarë, KEC, f. 77

⁴ Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shoqëri dhe shkolla, Prishtinë, shkurt 2009

Një tjetër lloj dhune e përhapur mjaft shumë është ajo verbale. Nxënësit tregojnë se mësimdhënësit e tyre përdorin terma tejet ofendues ndaj tyre. Nga nxënësit e intervistuar mbi 75% e tyre pranojnë një gjë të tillë. Këto ofendime janë gjuhë ‘sulmuese’ por jo e urrejtjes, ngase për t’u cilësuar si gjuhë e urrejtjes, duhet që së pari shprehja e përdorur të jetë kërcënuese ose fyese dhe *së dyti*, shprehja e përdorur duhet të ketë pasur për qëllim urrejtje racore ose të ketë qenë po thuaj për një gjë të tillë.⁵

Fjalët dhe shprehjet ofenduese më të shpeshta të përdorura nga mësimdhënësit :

Fjalët/shprehjet	Fjalët/shprehjet
Budallë, budallicë , i huptë	Qorr
Gomar	kryemadh
Kafshë	dreq
Hajvan	maniak
Lope	rrugaç
Idiot	kokëbosh
Pis	gogol

Nga intervistimet e bëra, vërehet qartë se dhuna psikike është një tjetër lloj i dhunës i cili përdoret në shkolla. Kjo lloj dhune kryesisht ushtrohet nga bashkëmoshatarët.

Faktorët nxitës të dhunës

Vetëm gjatë vitit të kaluar janë shënuar rreth 351⁶ incidente ku pjesëmarrës kanë qenë nxënësit. Madje 9 raste kanë përfunduar me lëndime të rënda trupore. Ekspertët e fushës së psikologjisë, vlerësojnë se janë një numër faktorësh që po e shkaktojnë nxitjen e dhunës te të rinjtë. Një nga faktorët që ndikon në ushtrimin e dhunës nga nxënësit është ekspozimi direkt ndaj dhunës qoftë edhe përmes video-lojërave apo *televizionit*.⁷ Nëse fëmijët shikojnë herë pas here skena të dhunës, atëherë gjasat janë që të mos ketë pasoja afatgjate, mirëpo, nëse i ekspozohen dhunës përmes video lojërave, e që janë mjaft aktuale tek ne, dhe nëse shikojnë televizion në

⁵ Methasani , E & Mushkolaj, G(2002)Edukimi I UNESCO-s për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri. Fjalor terminologjik i të Drejtave të Njeriut. Terma dhe Shprehje Bazë të të drejtave të Njeriut në Shqip/ Anglisht/ Shqip Tiranë, f. 53 -57

⁶ Policia e Kosovës,raporti i vitit 2012

⁷ Afërdita Goçi-Uka, psikiatër në Qendrën për shëndetin mendor për fëmijë dhe adoleshentë,intervistë,Kosovapress.

mënyrë të vazhdueshme, atëherë pasojat do të jenë afatgjatë, pasi që do të ketë ndryshime në mënyrën e të menduarit të fëmijët, të cilët do ta konsiderojnë dhunën si diçka normale dhe nuk do të shqetësohen aspak nëse lëndojnë ndokënd, ose nëse shohin se dikush po e lëndon dikë tjetër. Psikologu Dashmir Bërxulli, i cili për një kohë të gjatë është marrë me studimin e fenomenit të dhunës të nxënësit, shpjegon se ndër faktorët e parë që e nxisin dhunën nëpër shkolla, është toleranca shoqërore ndaj fenomenit të dhunës.⁸Sipas Bërxullit, mbetemi ende shoqëri tradicionale, e cila bazohet në zgjidhjen e problemeve përmes forca. Poashtu nuk punohet shumë dhe nuk mësohen nxënësit se si t'i zgjidhin problemet në mënyrë kreative, në mënyrë konstruktive, duke mos kërkuar që t'i zgjidhin problemet e tyre nëpërmjet dhunës.

Konstatimet

Përballë zvogëlimit të dhunës fizike dhe psikike të mësimdhënësve mbi nxënës, kemi një rritje rapide të keqtrajtimit të fëmijëve nga fëmijët moshatarë. Keqtrajtimi i fëmijëve nga fëmijët moshatar në vitin 2003, ka qenë dukuri e rastit me një përqindje më të vogël se një përqind , ndërsa tani delikuenca e të miturve është 7.4%. Është më e madhe se sa dhuna fizike e mësimdhënësve mbi nxënës. Nëse nuk hartohet një projekt për parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve nga fëmijët treguesit do të rriten në mënyrë rapide , kështu që mjediset në shoqëri do të jenë edhe më të dhunshme dhe pengesë serioze për demokratizimin e shoqërisë kosovare.

Poashtu bashkëpunimi ndërmjet organeve dhe organizatave të ndryshme të shoqërisë civile dhe të institucioneve formale nuk është në nivelin e duhur. Mosbashkëpunimi i programuar dhe i koordinuar vështirëson punën në krijimin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane/ miqësore në shoqëri dhe në shkolla

Ky hulumtim i shpejtë i gjendjes së nxënësve në Kosovë, na ka krijuar mundësinë që të vërtetojmë hipotezën gjenerale se : “ Në Kosovë, mjediset nuk janë të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/ miqësore në masë që ato të jenë hapësira të përshtatshme për zhvillimin e plotë të personalitet të fëmijës dhe të vendosjes së njeriut – fëmijës në qendër”, sidhe nënhipotezën: “Dhuna mbi fëmijë në shoqëri dhe në shkolla është akoma e përhapur në masën që kalon 40% të fëmijëve në Kosovës”.

⁸ Intervistë, Radio Kosova e Lirë, 14 gusht 2013

Bibliografia

- MALNES, R. & MIDGAARD, K. Filozofia politike, kapitujt 21-23, Rozafa, Prishtinë, 2009
- EL HASHIMI, M. Shoqëria ideale, Idea, Prishtinë 2009
- UNICEF(2009) : Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shoqëri dhe shkolla, Prishtinë
- HYSANI, H : Të drejtat e nxënësve në sytë e nxënësve kosovarë, KEC, Prishtinë, 2004
- UNESCO: Stopping violence in schools- a guide for teachers, Prishtinë, 2009
- UNICEF: Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës, Prishtinë, 2005
- UNICEF: Analizë e gjendjes së arsimit në Kosovë, Prishtinë, 2004
- UNICEF: Quality Education for All in Kosovo, Prishtinë, 2005
- UNIFEM: Propozimi i Planit Veprues për Arritjen e Barazisë Gjimore, Prishtinë, 2002
- MUSHKOLAJ, Gj. Fjalorth terminologjik i të drejtave të njeriut, Prishtinë, 2002
- Policia e Kosovës, raporti i vitit 2012, Mitrovicë
- UNICEF: Prirëçnik.Stop nasillju ređju decom.Projekat ZA SIGURNO I POTENCIALNO OKRUŽENJE U ŠKOLAMA. Prevencija i borba protiv nasila ređju djecom (2003- 2005, f.13)